


PROF. LEKË GJIKNURI

(1938 –2001)

TOPUZI L., MIHO A.

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Biologjisë

Prof. Lekë Gjicknuri u lind në Kudhës (Himarë), më 18 gusht 1938, nga një familje me tradita patriotike dhe arsimdashëse. Babai i tij, Panajoti, ka qenë një nga themeluesit dhe mësuesit e parë të shkollës shqipe në krahinën e Himarës. Ai e kreu arsimin fillor në fshatin e tij të lindjes dhe arsimin e mesëm në gjimnazin 'Qemal Stafa', në Tiranë. Në vitin 1957 filloi studimet e larta për biologji në Sofje, të cilat i përfundoi në vitin 1962 në Universitetin e Tiranës në degën Biologji-Kimi. Mbështetur në përgatitjen dhe rezultatet me të cilat përfundoi studimet universitare, qysh prej vitit 1962 u emërua asistent dhe më pas pedagog në katedrën e zoologjisë, pranë Fakultetit të Shkencave Natyrore, ku me ndonjë ndërprerje të vogël, punoi deri në fund të jetës (2001). Në vitin 1981 fiton gradën shkencore Kandidat i Shkencave e më pas Doktor. Në vitin 1985 merr titullin Docent dhe në vitin 1994 titullin Profesor.



Për formimin shkencor dhe pedagogjik, aftësitë organizuese dhe ndjenjat patriotike, Z. Lekë Gjicknuri u ngarkua me përgjegjësi dhe detyra të rëndësishme në fushën e arsimit, shkencës dhe ato shoqërore. Prej vitit 1982 e deri në 1990, ai ka drejtuar katedrën e Zoologjisë dhe për disa vite Këshillin e Degës së Biologjisë. Ka qenë anëtar i Këshillit Shkencor të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Institutit të Peshkimit, Durrës. Ka qenë anëtar i Redaksisë së Buletinit të Shkencave Natyrore dhe i Redaksisë së Fjalorit Enciklopedik Shqiptar (FESH). Prej vitit 1991 e deri në fund ka drejtuar shoqatën 'Ruajtja dhe Mbrojtja e Mjedisit Natyror në Shqipëri'. Në vitin 1995 është zgjedhur anëtar i Këshillit Bashkiak të Tiranës dhe në vitin 1997 deputet

në Kuvendin Popullor e njëkohësisht nënkryetar i Komisionit të Shëndetësisë dhe Mjedisit pranë tij.

Gjatë gjithë jetës, Prof. Gjicknuri ka pasur aktivitet të gjerë e të shquar në procesin mësimor, shkencor e shoqëror në degën e Biologjisë, në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe më gjerë. Falë përgatitjes së gjerë teorike e aftësive organizuese, ka dhënë ndihmesë të veçantë në zhvillimin e arsimit të lartë, ka kontribuar në riorganizimin e Katedrës së Zoologjisë dhe gjithë degës së Biologjisë. Si përgjegjës katedre, si kryetar Këshilli Dege dhe si anëtar i Këshillit Shkencor të Fakultetit, ai ishte në krye të punëve të rëndësishme për rishikimin e përmirësimin e vazhdueshëm të planeve dhe programeve mësimore të degës, duke i ballafaquar me ato të vendeve të zhvilluara, detyrë të cilën e kryente me shumë vullnet e pasion. Këtu, një meritë të veçantë ka për hapjen e drejtimit të ri pesëvjeçar të biologjisë, e cila ndihmoi shumë në zhvillimin e degës dhe shkencave biologjike në përgjithësi.

Prof. Gjicknuri është dalluar gjithmonë si lektor i apasionuar, mjaft i qartë dhe konkret. Leksionet e tij në të gjitha disiplinat që ka zhvilluar kanë qenë me nivel të lartë, shkencor dhe metodik. Ai i kushtonte rëndësi të veçantë gjuhës, duke shmangur në maksimum termat e huaja, në leksione, tekste dhe në gjithë publicistikën e gjerë të tij. Fillimisht ai u aktivizua në drejtimin e punëve praktike laboratorike në zoologji. Për herë të parë hartoi praktikumin për të dy pjesët e lëndës (viti 1974, 408 faqe), e cila çoi, padyshim, në përmirësimin e dukshëm, cilësor dhe sasior, e punëve laboratorike. Atij ju besua drejtimi i zhvillimit të leksioneve në lëndën e biologjisë së përgjithshme, në Fakultetin e Mjekësisë. Së bashku me Prof. Tefta Rexhën, me një punë këmbëngulëse, me pasion dhe përkushtim, mbështetur në arritjet më të fundit, mundën jo vetëm të përgatitnin leksione të nivelit të lartë, por edhe të hartonin më pas (1990) tekstin mësimor përkatës (535 faqe), i cili dallohet për informacionin e gjerë dhe përmbajtjen bashkëkohore.

Pas Prof. Islam Zekos, duke qenë ndër më të përgatiturit dhe më me eksperiencë në katedër, nga viti 1982 iu besua zhvillimi i lëndës së rëndësishme të Zoologjisë së Parruazorëve, të cilën e vazhdoi deri në fund. Nën drejtimin e tij, kjo lëndë pësoi rritje të ndjeshme. Kjo duket edhe në tekstin përkatës të hartuar prej tij, i cili është ndër më cilësorët e degës së biologjisë (viti 1994, 500 faqe), me informacion të zgjeruar bashkëkohor, por edhe i dalluar për trajtimin metodik, gjuhën e qartë dhe të pastër. Me formimin e drejtimit të ri të biologjisë, Prof. Gjicknuri zhvilloi edhe lëndën e re të Hidrobiologjisë, ku hartoi programin, përgatiti e zhvilloi leksionet dhe labororet dhe, së fundi, përfundoi edhe dorëshkrimin e tekstit mësimor përkatës, i cili nuk mund të botohej. Në lëmin botues, si bashkëautor ai ka

dhënë ndihmesë edhe në hartimin e disa teksteve për shkollën e mesme dhe tetëvjeçare.

Prof. Gjinkuri ka dhënë ndihmesë të shquar në organizimin dhe kërkimin shkencor në katedrën e Zoologjisë, degën e biologjisë e më gjerë. Me aftësitë e tij organizuese, pasionin e thellë për punën kërkimore, kulturën e gjerë biologjike, punoi që puna kërkimore të vihej në baza sa më të shëndosha shkencore. Për këtë arsye, ai këmbëngulte në planifikimin e veprimtarisë kërkimore, në hartimin e metodikave të hollësishme dhe në kontrollin periodik të rezultateve. Në fushën e specialitetit, ai u përpoq për studimin e faunës detare dhe mund të konsiderohet ndër pionerët e kërkimeve hidrobiologjike nënujore. Në doktoraturën e tij *'Rezultate të studimit të ekinodermatëve të bregdetit tonë'* bëhet fjalë për studimin e një grupi tipik të biodiversitetit shqiptar (yjet dhe iriqët e detit), mjaft interesant për vlerësimin e habitateve ujore. Studimi disaveçar shtrihet thuajse gjatë gjithë bregdetit shqiptar, ku jepen për herë të parë përhapja e rreth 46 llojeve me të dhëna morfologjike dhe ekologjike, në diskutim krahasues me rajonin e Mesdheut, si dhe jepen vlerat shkencore, natyrore dhe praktike të tyre. Ai ka dhënë ndihmesë edhe me studime të tjera shumë të larmishme e interesante, kryesisht në vlerësimin në përgjithësi të faunës së bregdetit dhe në ruajtjen e saj dhe të gjithë zonës bregdetare. Bëhet fjalë në mbi 20 publikime me vlera teorike dhe praktike, të botuara brenda dhe jashtë vendit, të cilat përbëjnë një bazë për studimet e mëtejshme faunistike detare. Gjithashtu, mbi 12 referate dhe kumtesa, disa edhe me bashkëautorë, janë mbajtur në aktivitete shkencore ndërkombëtare (kongrese ose konferenca), në Ballkan, Evropë dhe më gjerë.

Prof. Gjinkuri i jepte rëndësi të madhe procesit të formimit e kualifikimit të kuadrit të ri. Ai ishte kërkues, si ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve, ku synonte gjithmonë t'u transmetonte bashkëpunëtorëve dëshirën për të ecur përpara në drejtimit speciale, nevojën e informimit shkencor sa më të plotë, shfrytëzimin e burimeve bibliografike, mësimin gjuhëve të huaja dhe njohjen e vazhdueshme të arritjeve të shkencës botërore. Me këto cilësi ai udhëhoqi punonjës të rinj të shkollës së lartë dhe të prodhimit, në punën e tyre kërkimore, disa deri në mbrojtjen e doktoraturës. Ai me shumë dëshirë aktivizonte edhe studentët, duke i ushqyer ata me pasionin për kërkimin shkencor, për shkencat biologjike e veçanërisht për ato zoologjike.

Me ndryshimet e sistemit në Shqipëri, problemet mjedisore të trashëguara u thelluan dhe u bënë më të mprehta. Në gjithë këtë ecuri të zhvillimit të Shqipërisë dhe të problemeve mjedisore nuk ka munguar kurrë mendimi progresiv dhe mbështetës i ruajtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të natyrës dhe burimeve të saj biologjike, ku Prof. Gjinkuri, për gati 20 vjet ka qenë në

pararojë. Qysh prej vitit 1991 e deri në fund, ai drejtoi me pasion dhe kompetencë shoqatën e Ruajtjes dhe Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri, ku arrin të bëhet figurë e spikatur e lëvizjes mjedisore shqiptare. Përpjekjet për mbrojtjen mjedisore u bënë mbizotëruese gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, dhe shoqata fitoi shpejt edhe një reputacion të madh në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare. Shumë aktivitete me karakter ndërgjegjësuës, informues, por edhe me karakter zbatues mjedisor, janë fryt i bashkëpunimit me fondacione ose shoqata jo qeveritare fqinje ose më gjerë, në të cilat padyshim spikat figura e Prof. Gjinkurit. Gjatë kësaj periudhe ai bëhet anëtar ose i deleguar në disa organizma ndërkombëtare mjedisore të dëgjua, si Ligatinat Ndërkombëtare (1991), në komitetin e bentosit të CIESM (1992), në EUCC (1993), GLOBE Europe (1998), MEDWET (1998).

Aftësitë drejtuese të Prof. Gjinkurit u shprehën shpesh edhe në drejtimin politik, si deputet ose këshilltar në qytetin e Tiranës. Ai ishte patriot dhe jetonte me përparimet, hallet e shqetësimet e vendit të tij. Këto cilësi që e kanë shoqëruar atë gjithmonë, u theksuan më shumë gjatë kohës si deputet. Duke shfrytëzuar shpesh forumet drejtuese, shohim shpesh përkushtimin e zjarrtë për zgjidhjen e shumë çështjeve të lidhura me mësimdhënien ose mbrojtjen e mjedisit. Shpesh është dalluar tek ai shpirti i 'rebelit' i cili karakterizohej nga kurajua e madhe për të kritikuar ndaj shqetësimeve të vërejtura. Bashkëkohësit mund të kujtojnë diskutimet nga tribuna parlamentare, ku spikatin debati për vendosjen e paragrafeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e burimeve natyrore në kushtetutën e re shqiptare, për hartimin dhe miratimin e shumë ligjeve të tjera mjedisore. E madhe ka qenë ndihmesa e dhënë, gjithashtu, në antarësimin e Shqipërisë në shumë Konventa Ndërkombëtare me karakter mjedisor.

Prof. Lekë Gjinkuri do të kujtohet gjithmonë si pedagog i talentuar, si shkencëtar i formuar, si patriot me kurajo për të thënë pandrojtje fjalën e tij në çdo rast. Në këtë përvjetor, vepra e tij kujtohet me respekt të thellë nga gjithë miqtë, kolegët dhe bashkëpunëtorët, studentët dhe shumë të tjerë. Ajo është pa dyshim frymëzim për gjithë brezat e tashëm dhe të ardhëm që me përgjegjësi profesionale e patriotizëm të çojnë përpara zhvillimin shoqërisë shqiptare.